



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

*Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.*

**1.Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023, Departamenti i Administratës Publike ka realizuar procesin e konsultimit publik për një projektakt, konkretisht projektligji “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Projektligji do të zbatohet për të punësuarit në institucionet e administratës publike, ku më konkretisht përfshihen funksionarët e zgjedhur apo të emëruar të përcaktuar në këtë projektligj, nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë në institucionet e administratës shtetërore, Forcat e Armatosura, përfaqësitë, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë e fondeve speciale dhe ndërmarrjet shtetërore me kapital mbi 50 për qind shtetëror. Gjithashtu, përjashtimit projektligji për: (i) efekt të përcaktimit të pagës minimale në shkallë vendi, do të jetë i detyrueshëm për zbatim edhe për sektorin privat; (ii) për efekt të parimeve për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, do të ishte i detyrueshëm për zbatim edhe për institucione/ente të tjera të sektorit publik që nuk përfshihen në fushën e veprimit të tij.

Sa më lart, duke mbajtur në konsideratë që fusha e veprimit të projektligjit ishte e gjerë dhe si rezultat palët e interesuara mund të ishin të shumta, publikimi i projektaktit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike u vlerësua si metoda më efektive për konsultimin publik.

Konsultimi u hap me publikimin e projektaktit në REKNJ më datë 21.3.2023 dhe u mbyll më 17.4.2023.

Në përfundim të konsultimit elektronik, megjithëse numri i vizitorëve në RENJK ishte i konsiderueshëm, rezultoi se nuk kishte komente në lidhje me projektligjin.

## **2.Analiza e konsultimeve të kryera**

### **2.1.Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike**

#### **2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?**

Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, numri i përgjithshëm i akteve të miratuara, të cilat janë propozuar nga Departamenti i Administratës Publike, është 20 akte, ndër të cilat 1 ligj dhe 19 vendime të Këshillit të Ministrave.

#### **2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” parashikohet se aktet që i nënshtrohen konsultimit publik janë projektligjet dhe projektvendimet që miratojnë dokumente strategjike dhe politika me interes të lartë publik.

Sa më sipër, vetëm një prej projektakteve të miratuara gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023 është objekt i konsultimit publik, konkretisht projektligji “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”. Ky projektakt i është nënshtuar konsultimit publik, në përputhje me ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

### 2.1.3. *Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?*

Projektligji i vetëm që i është nënshtuar konsultimit publik gjatë periudhës së raportimit ka qenë i shoqëruar me raport të vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR-je).

### 2.1.4. *Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përrjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?*

Për 6 mujorin e parë të vitit 2023, Departamenti i Administratës Publike nuk ka akte të planifikuara në PPAP, PKIE apo dokumentet strategjike të sektorit. Si rrjedhim, kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik nuk janë aplikuar për asnjë akt.

### 2.1.5. *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?*

Akti i konsultuar gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023 ishte projektligj.

### 2.1.6. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Vitin e kaluar, asnjë projektakt i përgatitur nga Departamenti i Administratës Publike nuk ka qenë objekt i konsultimit publik. Si rezultat, nuk mund të bëjmë një analizë krahasuese mes 2 periudhave.

## 2.2. **Metodat e konsultimit**

### 2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metoda e përdorur për konsultimin publik të projektligjit “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” ishte konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, pra përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

*2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Sikurse u përmend më lart, gjatë periudhës së raportimit u përdor vetëm një metodë konsultimi.

*2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Për projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” nuk janë organizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit, por theksojmë që ky projektligj është hartuar nga grupi i punës me përfaqësues nga kabineti i Zëvendëskryeministrit, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**2.3.Kohëzgjatja e konsultimeve**

*2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Për periudhën 20 ditë punë të konsultimit publik për projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, e vetmja metodë konsultimi e aplikuar ishte konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, e zgjedhur si metoda më efektive në këtë rast.

*2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Konsultimet në RENJK zgjatën 20 ditë pune. Ato u hapën më datë 21.3.2023 dhe u mbyllën më datë 17.4.2023.

*2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vitin e kaluar, asnjë projektakt i përgatitur nga Departamenti i Administratës Publike nuk ka qenë objekt i konsultimit publik. Si rezultat, nuk mund të bëjmë një analizë krahasuese mes 2 periudhave.

**2.4.Palët e interesuara të përfshira**

*2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në hartimin e projektligjit “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” nuk kanë marrë pjesë aktorë të jashtëm, jo qeveritarë. Ky projektakt është hartuar nga kabineti i Zëvendëskryeministrit, Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**2.4.2** *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

Sikurse u përmend më lart, nuk ka patur pjesëmarrje të anëtarëve të jashtëm në grupet e punës.

**2.4.3** *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Nga këqyrja e faqes zyrtare të konsultimit publik, RENJK, rezulton se numri i shikimeve/vizitorëve për projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” ka qenë 1152, por në përfundim të konsultimit elektronik nuk pati komente.

**2.4.4** *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Në konsultimet publike për projektligjin “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” nuk pati kontribues që morën pjesë/dhanë komente.

**2.4.5** *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Vitin e kaluar, asnjë projektakt i përgatitur nga Departamenti i Administratës Publike nuk ka qenë objekt i konsultimit publik. Si rezultat, nuk mund të bëjmë një analizë krahasuese mes 2 periudhave.

## **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

**2.5.1.** *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Numri i komenteve dhe rekomandime të marra gjatë konsultimit publik përmes RENJK ka qenë 0 (zero).

*2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Numri i komenteve dhe rekomandime të marra gjatë konsultimit publik përmes RENJK ka qenë 0 (zero).

*2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Vitin e kaluar, asnjë projektakt i përgatitur nga Departamenti i Administratës Publike nuk ka qenë objekt i konsultimit publik. Si rezultat, nuk mund të bëjmë një analizë krahasuese mes 2 periudhave.

*2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

Sikurse u përmend më lart, gjatë konsultimit publik nuk janë marrë komente apo informacione/të dhëna. Si rezultat, asnjë raport VNR-je nuk ka pësuar ndryshim pas konsultimit publik.

**2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

*2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023, është publikuar 1 (një) raport i konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

*2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk ka patur raporte të konsultimit publik të papublikuara.

**2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeks të cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)**

Indeksi i performancës institucionale për konsultimin e projektligjit “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” – 8 pikë.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Duke marrë në konsideratë mungesën e komenteve/rekomandimeve gjatë konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, të projektligjit “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, vlerësojmë se sfida kryesore në drejtim të konsultimit publik është angazhimi aktiv i publikut. Për të adresuar këtë problematikë, përveç përdorimit të metodave të ndryshme të konsultimit publik (në veçanti organizimi i tryezave të konsultimit me ekspertë të fushës), përpjekje të shtuara duhet të ndërmerren në drejtim të informimit të publikut për ekzistencën e instrumentit të konsultimit publik.